

Përmbledhja e  
mbledhjeve të  
studimeve të  
grantistëve

МРЕЖА

23

Shkup, korik 2015



Botues  
Instituti për politikë Europiane - Shkup

Për botuesin:  
Dr. Malinka Ristevska Jordanova

Redaktore  
Dr. Malinka Ristevska Jordanova

Përkthim dhe lekturë  
Blerina Starova Zllatku

CIP - Katalogizacija vo publikacija  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

061.2:[347.96/.99:347.2(497.7)(047)

PERMBLEDHJA e mbledhjeve te grantisteve / [përkthim Blerina Starova Zllatku]. - Shkup : Instituti për politikë Europiane, 2015. - 36 стр. : табели ; 21 см

Фусноти кон текстот. - Публикацијата е во рамките на проектот: "Rrjeti 23"

ISBN 978-608-4702-17-7

а) Граѓански организации - Човекови права и слободи - Евалуација на правосудство - Македонија - Извештаи  
COBISS.MK-ID 99647498

Ky publikim u mundësua me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të Projektit "Rrjeti 23", i cili u implementua përmes: Institutit për Politikë Evropiane; Qendrës për Menaxhimin me Ndryshime dhe Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Qëndrimet e prezantuara në këtë publikim janë qëndrime të autorëve dhe çdoherë nuk i pasqyrojnë qëndrimet e Bashkimit Evropian. Projektin financiarisht e mbështeti edhe Mbretëria e Holandës.

përmbajtje

Këshill Gjyqësor i pavarur i Republikës së Maqedonisë – synimi dhe sfidat .....	2
Pavarësia dhe objektiviteti i organeve të jurisprudencës në Komunën e Strumicës – sfidë për reforma ose postulatet e bazuara? .....	7
“Burimet e financimit, lartësia e mjeteve të siguruara dhe ndikimi i tyre mbi pavarësinë e pushtetit gjyqësor” .....	9
“Cili është çmimi i lirisë së shprehjes në Maqedoni?” .....	12
“Mediat, pronarët, gazetarët dhe të drejtat e punëtorëve”.....	14
Analizë e mekanizmave për mbrojtjen nga diskriminimi të bashkësive të marginalizuara në nivel lokal: Komuna e Manastirit, Komuna e Strumicës dhe Komuna Qendër .....	17
Monitorimi i implementimit të standardeve ndërkombëtare për gjykim të ndershëm dhe të drejtë .....	19
Sistemi i masave alternative, me vështrim të veçantë mbi gjendjen e implementimit në Komunën e Prilepit .....	22
“Analizë e zbatimit të Ligjit për ndihmë juridike falas, përfshirë edhe analizën (cost-benefit analysis) e shpenzimeve për zbatimin e saj, me theks të veçantë mbi aspektin gjinor” .....	27
Rrugët e reja në Shkup dhe të drejtat e liritë themelore nga Karta e BE .....	30

## **Parathënie**

Qëllimi kryesor i Projektit “Rrjeti 23”, të cilin e realizon Instituti për Politikë Evropiane – Shkup, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë dhe Qendra për Menaxhimin me Ndryshimet, është kontribut i strukturuar i shoqërisë civile në monitorimin dhe vlerësimin e politikave të përfshira me Kapitullin 23 – Jurisprudenca dhe Të Drejtat Themelore.

Përmes Projektit, në mënyrë transparente, iu ndanë dhjetë grante organizatave të tjera qytetare, të cilat zbatuan hulumtime dhe aktivitete të tjera si kontribut për monitorimin dhe vlerësimin efektiv të politikave të përfshira me Kapitullin 23 nga anëtarësimi në BE. Si produkt final i hulumtimeve të këtilla, u përpiluan dokumente për politikë publike, me rekomandime për tejkalimin e problemeve të përcaktuara. Të dhënat e tyre janë përfshirë në Analizën e fushave nga Kapitulli 23 “Jurisprudenca dhe Të Drejtat Themelore në Republikën e Maqedonisë”, si “Raport i parë në hije” të organizatave qytetare maqedonase për gjendjet në fushat që i përfshin ky Kapitull. Në bashkëngjitje janë rezymetë e dokumenteve për politikat publike.

## Instituti për të Drejtat e Njeriut - Shkup



Институт за човекови права

### Këshill Gjyqësor i pavarur i Republikës së Maqedonisë – synimi dhe sfidat

Duke u nisur nga misioni i tij për promovimin, avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, Instituti për të Drejtat e Njeriut, e implementoi këtë Projekt me qëllim që të kontribuohet në drejtim të realizimit cilësor të të drejtës së njeriut për një gjykim të pavarur dhe të paanshëm në realizimin e të drejtave nga fusha penale, civile dhe juridike administrative, si dhe me qëllim të realizimit të pavarësisë, objektivitetit dhe transparencës së punës së Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.

Ky Projekt do të kontribuojë në drejtim të zbatimit konsekuent të kompetencave të përcaktuara ligjore dhe detektimit eventual të nevojës për ndryshime të caktuara në zgjidhjet ekzistuese ligjore ose në drejtim të miratimit të akteve të reja normative në këtë fushë, në mënyrë që të stimulohet dhe të mundësohet rritja e pavarësisë dhe objektivitetit në procedurat e zgjedhjes, shkarkimit dhe shqiptimit të masave disiplinore të gjyqtarëve në Republikën e Maqedonisë. Në këtë mënyrë do të përforcohet përgjegjësia dhe llogaridhënia, si e këtij e Institucioni ndaj qytetarëve, ashtu edhe e gjyqtarëve, e që është jashtëzakonisht e rëndësishme në këtë kohë, kur besimi ndaj sistemit gjyqësor është në nivel shumë të ulët.

Gjatë realizimit të Projektit, Instituti për të Drejtat e Njeriut, analizoi dispozita nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Ligji për Këshillin Gjyqësor të RM-së me ndryshimet dhe plotësimet e realizuara edhe në kohën e përpilimit të Analizës, Ligji për Këshillin për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përgjegjësinë e Gjyqtarit, po ashtu i miratuar në periudhën e përpilimit të Analizës, nga ligjet të cilët përmbajnë dispozita të cilat në përgjithësi kanë të bëjnë me sigurimin e pavarësisë në sistemin gjyqësor dhe Draft-Amendamentet Kushtetuese realizimi i të cilave, edhe pse është në procedurë parlamentare, është i pasigurt. Gjatë përpilimit të Analizës janë marrë parasysh standardet të cilat rezultojnë nga dokumentet ndërkombëtare, veçanërisht nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nga dokumentet e organizatave ndërkombëtare që kanë të bëjnë me pavarësinë dhe paanshmërinë e organeve të jurisprudencës në Republikën e Maqedonisë. Përveç kësaj, u monitorua edhe puna e Këshillit Gjyqësor të RM-së, u analizuan vendimet e plotfuqishme të tij, u realizuan intervista me kandidatë të pazgjedhur për gjyqtarë, me gjyqtarë të shkarkuar, me gjyqtarë kundër të cilëve janë zhvilluar procedura disiplinore dhe me gjyqtarë të pensionuar. Njëkohësisht, u dërguan edhe pyetësorë anketues deri tek të gjithë anëtarët e Këshillit Gjyqësor, të cilët për fat të keq nuk iu përgjigjën të njëjtëve. Nga ana tjetër, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë nuk i dërgoi informatat e kërkuara, në lidhje me vendimet

sipas ankesave të vendimeve të Këshillit Gjyqësor, me arsyetimin se e mbrojnë privatësinë dhe të dhënat personale.

Së këtejmi, njëri nga aktivitetet kishte të bënte me hulumtimin e opinionit publik, në drejtim të matjes së perceptimit të qytetarëve për rëndësinë dhe funksionimin e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.<sup>1</sup> Sipas këtij hulumtimi, një përqindje më e madhe e qytetarëve të RM-së (56%) konsiderojnë se KGJRM për zgjedhjen e kandidatëve për gjyqtar e bën nën presion. 23,5% konsiderojnë se për zgjedhja bëhet nën presion të plotë, ndërsa 32,7% konsiderojnë se për zgjedhja bëhet kryesisht nën presion. Kemi një përqindje të lartë të qytetarëve të cilët mendojnë se disa faktorë të caktuar të jashtëm ndikojnë mbi pavarësinë dhe autonominë e punës së KGJRM. Prej atyre të cilët u përgjigjën se ndikojnë faktorë të jashtëm, edhe tek maqedonasit edhe tek shqiptarët, përqindja më e madhe e qytetarëve konsideron se pushteti është ai i cili ka influencë më të madhe mbi pavarësinë dhe autonominë e punës së KGJRM. Kjo përqindje është në lartësi prej 48% tek maqedonasit dhe 62% tek shqiptarët.

Në bazë të aktiviteteve projektuese, u hartua Analiza për pavarësinë e Këshillit Gjyqësor të RM-së nga e cila rezultuan këto konkluzione:

1. Ligji për Këshillin për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit dhe Ligji për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RM-së janë miratuar me procedurë të shkurtuar, pa konsultimin e palëve të interesuara dhe pa debat publik. Ata përmbajnë një varg mangësish, në kuptimin e zgjidhjeve të paqarta ligjore, si nga aspekti i strukturës organizative të kompetencave të Këshillit Gjyqësor të RM-së dhe Këshillit për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit, si dhe në aspekt të funksionimit të të dy organeve. Në një situatë të këtillë mund të konkludohet se nuk është arritur qëllimi për përmirësimin e pavarësisë dhe autonomisë së sistemit gjyqësor ashtu siç e thekson propozuesi i ligjeve.
2. Ligji për Këshillin për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit nuk ka bazë kushtetuese për miratimin e tij, siç është rasti me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të RM-së, ndërsa referimi në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të RM-së nuk mund të jetë bazë për miratimin e këtij Ligji, veçanërisht sepse edhe Propozim-Amendamentet Kushtetuese, të cilët janë në procedurë, nuk parashikojnë themelimin e një organi të tillë.
3. Zgjidhjet ligjore për Këshillin e formuar të ri për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit, si dhe për Këshillin ekzistues Gjyqësor të RM-së nuk parashikojnë përgjegjësi për anëtarët e këtyre dy këshillave e as nuk parashikojnë sigurimin e transparencës thelbësore të punës së tyre.

<sup>1</sup>Me anketën u përfshin 1200 të anketuar nga 80 komuna, me përfshirje reprezentative të të gjitha bashkësive etnike, mjediseve dhe rajoneve urbane dhe rurale. Anketa është realizuar në periudhën kohore nga 22 deri më 25 dhjetor të vitit 2014. Gabim i mundshëm statistikor: +/-4,3%.

4. Janë të paqarta dhe të pa harmonizuara dispozitat e ligjeve të analizuara me kornizën ekzistuese ligjore nga fusha e gjyqësorit (Ligji për gjykatat, Ligji për procedurë kontestimore dhe Ligji për marrëdhënie detyrimore) nga aspekti i sigurimit të sigurisë juridike dhe veprimit identik kur bëhet fjalë për afatin e ngritjes së procedurës për punë joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të gjyqtarit, kur bëhet fjalë për ngritjen e procedurës pas pranimit të vendimit nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe në kontekst të dhënies së mundësisë që të sigurohet qartë, konkretisht dhe e mbështetur me argumente përcaktimi i përgjegjësisë individuale të gjyqtarit, veçanërisht sepse ekziston mundësia ligjore për përsëritjen e procedurës para gjykatave nacionale pas pranimit të vendimit nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
5. Nuk ekziston mjet përkatës juridik sa i përket realizimit të të drejtës së ankesës të kandidatit të pakënaqur – gjyqtarit në procedurën e përzgjedhjes së gjyqtarëve.
6. Nuk është siguruar procedurë e pavarur sipas mjetit juridik – kontestimi i vendimit për përgjegjësi disiplinore ose shkarkimi nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit. Anëtarësimi dhe votimi i kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, në mbledhjet për shkarkimin e gjyqtarit dhe për përgjegjësi disiplinore të gjyqtarit, nuk mund të neglizhohet dhe kjo mund të shkaktojë dyshime objektive në punën e pavarur të Këshillit për vendimmarrje sipas ankesave kundër vendimeve të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, të formuar nga ana e Gjykatës Supreme të RM-së. Dyshimi i këtillë është edhe rezultat i rrethanave sepse Rregullorja e Punës së Gjykatës Supreme të RM-së, në përputhje me të cilën duhet të rregullohet edhe formimi i Këshillit i cili vendos sipas ankesave, nuk është e aksesshme për publikun, ndërsa me përmbajtjen e saj personat e interesuar të tretë nuk mund të informohen dhe ta analizojnë të njëjtën.
7. Nga anketa e zbatuar, për punën e Këshillit Gjyqësor të RM-së, konstatohet se të anketuarit pjesërisht kanë besim në punën e këtij organi duke llogaritur se përzgjedhja, procedura disiplinore dhe shkarkimi i gjyqtarëve bëhet ekskluzivisht nën presionin e Qeverisë.
8. Vendimet e Këshillit Gjyqësor të RM-së nuk janë mjaftueshëm të argumentuar dhe të njëjtët kanë mangësi thelbësore juridike por edhe mangësi procedurale nga aspekti juridik, e që lë hapësirë për mosbesim të përgjithshëm në punën e këtij organi. Gjithashtu, mund të konstatohet se në raste të caktuara ka edhe qasje selektive në punën e tij.

Instituti për të Drejtat e Njeriut i përpiloi këto rekomandime:

1. Nevojitet analizë e plotë dhe rishikim të harmonizimit të këtyre ligjeve me Kushtetutën e RM-së dhe dokumentet ndërkombëtare në të cilët trajtohen standardet relevante për gjyqësor të pavarur dhe perceptimet e theksuara në Kapitullin 23 të raporteve të BE-së për progresin e Republikës së Maqedonisë.

2. Të ndërpritet procedura për përzgjedhjen e anëtarëve në Këshillin për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit, duke i marrë parasysh mangësitë e konstatuara, si dhe për shkak të situatës së krijuar të re për zgjidhjen e së cilës priten edhe orientime të tjera të qarta në sigurimin e parimit të gjyqësorit të pavarur.
3. Të miratohen plotësime të ligjeve ekzistuese, si në pjesën për përgjegjësi efektive të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të RM-së dhe Këshillit për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit, ashtu edhe në pjesën e sigurimit të transparencës thelbësore në punën e të dy këshillave.
4. Përcaktimi i dispozitave të qarta dhe konkrete ligjore për sigurimin e realizimit të Konkluzionit nr. 4. Nevojitet korrigjim i afatit të përcaktuar kur mund të kërkohet zbatim i institutit përsëritje e procedurës pas pranimit të vendimit nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në fushën juridike civile dhe juridike administrative. Ky afat do të duhej të rrjedhë nga momenti i pranimit të vendimit nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
5. Sigurimi i mjetit të pavarur dhe efikas juridik të kandidatëve të pakënaqur në procedurën e përzgjedhjes së gjyqtarëve. Zgjidhje më e zbatueshme për t'u siguruar mjeti juridik për kandidatët e pakënaqur, të cilët në procedurën e zgjedhjes nuk janë përzgjedhur si gjyqtar është të shtohet edhe një dispozitë në Ligjin për Këshillin Gjyqësor, në të cilën do të parashikohet që kandidatët e pakënaqur të kenë të drejtë të paraqesin padi për hapjen e kontestit administrativ para Gjykatës Administrative. Në një procedurë të këtillë paditësit do të kishin edhe të drejtën e ankesës deri te Gjykata e Lartë Administrative në rast të marrjes së vendimit negativ, ndërsa në këtë mënyrë do ta shfrytëzonin të drejtën e tyre për ankesë të garantuar me Kushtetutë. Duke i marrë parasysh ndryshimet kushtetuese që paraprijnë, konform draft-amendamenteve të propozuara, kandidatët e pakënaqur, pas miratimit të vendimit të Gjykatës së Lartë Administrative do të mund ta vazhdojnë procedurën para Gjykatës Kushtetuese, me paraqitjen e padisë kushtetuese, por vetëm sa i përket cenimit të së drejtës për veprim të ndershëm nga ana e organeve të cilët kanë vepruar dhe kanë marrë vendim në procedurën përkatëse.
6. Sigurimi i mjetit të pavarur dhe efikas juridik i pjesëmarrësve të pakënaqur – gjyqtarëve në procedurën për përgjegjësi disiplinore dhe në procedurën për shkarkimin e gjyqtarëve:
  - a) Rekomandimi i Institutit për të Drejtat e Njeriut për unifikimin e efikasitetit të mjeteve juridike, ndërsa me këtë edhe sigurimin e pavarësisë së gjyqësorit është të shfrytëzohet mundësia e parashikuar në Ligjin për konteste administrative dhe me ndryshimin e Ligjit për gjykata dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RM-së, në vend që të ekzistojë e drejta e ankesës deri te Këshilli për Vendosje sipas Ankesave pranë Gjykatës Supreme të RM-së, të parashikohet e drejta e padisë për ngritjen e kontestit administrativ para Gjykatës Kushtetuese dhe mjetit përkatëse juridik-ankesë para Gjykatës së



- Lartë Administrative. Në këtë mënyrë do të pushojë së funksionuari Këshilli për Vendosje sipas Ankesave pranë Gjykatës Supreme.
- b) Nëse ligjvënësi vendos që të mos i përfshijë gjykatat administrative në dy procedurat e theksuara dhe nëse mbetet zgjidhja ekzistuese ligjore, duhet të bëhen ndryshime përkatëse në procedurat para Këshillit Gjyqësor të RM-së dhe Gjykatës Supreme të RM-së, me çka do të përforcohet pavarësia dhe paanshmëria dhe do të rritet efikasiteti i mjetit juridik përkatës.
- c) Sa u përket mjeteve juridike, Instituti për të Drejtat e Njeriut pajtohet me iniciativën me të cilën janë paralajmëruar ndryshimet në Kushtetutë, gjyqtarët e shkarkuar ose gjyqtarët të cilëve u është shqiptuar masa disiplinore, përveç këtyre mjeteve juridike të kenë mundësi të paraqesin padi kushtetuese (ankesë) deri te Gjykata Kushtetuese e RM-së, por vetëm lidhur me cenimin e të drejtës së veprimit të ndershëm nga ana e organeve të cilët kanë vepruar dhe vendosur në dy procedurat e theksuara.
7. Ngritja e vetëdijes së qytetarëve përmes fushatës mediatike, broshurave dhe fletëpalosjeve për kompetencat dhe rëndësinë e Këshillit Gjyqësor të RM-së dhe eventualisht Këshillit të formuar të ri për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit, në realizimin e pavarësisë së gjyqësorit. Azhurnim i rregullt i ueb-faqes së Këshillit Gjyqësor të RM-së dhe eventualisht Këshillit të formuar të ri për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit, me postimin e informacioneve të cilët janë relevante dhe janë me interes për opinionin e gjerë në RM, si dhe postimin e rregullt të vendimeve të tyre dhe raporteve vjetore të punës.
8. Ndryshimi i praktikës në kontekst të përpilimit të vendimeve kualitative dhe mjaftueshëm të argumentuara të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, pa qasje selektive me inkorporimin e të gjitha të dhënave relevante, janë në drejtim të përmbushjes së standardeve ndërkombëtare në këtë fushë, për nevojat e personave të interesuar për informata me karakter publik, si dhe për interesin publik. Vendime të këtilla eventualisht duhet të miratojë edhe Këshilli i sapoformuar për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit.

Është evidente se ekzistojnë probleme në sistemin e jurisprudencës të Republikës së Maqedonisë dhe nevojitet një qasje domethënëse, serioze dhe cilësore në zgjidhjen e tyre. Vetëm me organizimin dhe formimin e organeve të reja, pa zbatim thelbësor dhe cilësor të parimeve të demokracisë dhe sundimit të së drejtës, nuk do të realizohet pavarësia e gjyqësorit në Republikën e Maqedonisë.

## Shoqata e Qytetarëve “NOVUS”



### **Pavarësia dhe objektiviteti i organeve të jurisprudence në Komunën e Strumicës – sfidë për reforma ose postulatet e bazuara?**

Shoqata “NOVUS”, si organizatë joqeveritare e cila vepron në nivel lokal, rajonal dhe shtetëror dhe e njëjta është e orientuar drejt përmirësimit dhe ngritjes së pozitës shoqërore dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe të rinjve, me theks të veçantë mbi mbrojtjen dhe afirmimin e të drejtave dhe lirive themelore, të garantuara me Kushtetutë, ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare, e realizon Projektin: **“Pavarësia dhe objektiviteti i organeve të jurisprudence në Komunën e Strumicës – sfidë për reforma ose postulatet e bazuara?”**.

Qëllimi i këtij dokumenti për politikë publike është të zbatojë analizë të pavarësisë dhe objektivitetit të jurisprudence në Komunën e Strumicës. Përmes këtij hulumtimi synohet drejt ofrimit të një analize të rastit, se sa është i pavarur dhe objektiv sistemi i jurisprudence në Komunën e Strumicës.

U anketua mendimi i qytetarëve në lidhje me pavarësinë dhe objektivitetin e jurisprudence në Komunën e Strumicës, mbi bazë të një modeli reprezentativ paraprakisht të përcaktuar përmes 253 të anketuarve në nivel të Komunës. Në kuadër të Projektit u realizuan edhe intervista me përfaqësues të organeve të jurisprudence, ndërkaq u dërguan edhe pyetësorë anketues deri te çdo gjyqtar në Gjykatën Themelore Strumicë. Krahas pyetësorëve anketues të cilët ishin konfidencial dhe anonim, që iu dërguan të gjithë gjyqtarëve, megjithatë vetëm 4 gjyqtarë iu përgjigjën pyetjeve të pyetësorit, kështu që i njëjti nuk mund të merret si model i besueshëm reprezentativ dhe në bazë të të cilëve do të mund ta përcaktonim perceptimin e gjyqtarëve për Gjykatën Themelore Strumicë. Kjo, mbase e pasqyron gjendjen se sa gjyqtarët në të vërtetë konsiderojnë se janë “të pavarur” dhe “objektiv”.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se **37% e të anketuarve nuk janë të kënaqur nga puna e Gjykatës, 31% janë pjesërisht të kënaqur**, ndërsa vetëm **5% janë plotësisht të kënaqur nga puna e saj**.

Madje **42% e të anketuarve fare nuk i besojnë Gjykatës Themelore Strumicë, kundrejt 6% të të anketuarve të cilët janë të kënaqur nga puna e saj**. Në lidhje me influencën e pushtetit qendror mbi pavarësinë e gjyqësorit në Komunën e Strumicës, **56% e të anketuarve janë prononcuar se gjyqësori është nën influencën e pushtetit qendror**, ndërsa vetëm **10% konsiderojnë se i njëjti nuk ka kurrfarë influence mbi Gjykatën Themelore Strumicë**. Sa i përket transparencës dhe objektivitetit të Gjykatës, vetëm **7% e të anketuarve janë përgjigjur se Gjykata në Strumicë është transparente dhe objektive**, e që është krejtësisht e kundërt në raport me qëndrimet të cilat i kishin përfaqësuesit e intervistuar të organeve të jurisprudence. Një përqindje solide prej **36% të të anketuarve ishin të**

**mendimit se Gjykata e Strumicës pjesërisht është transparente dhe objektive, e që paraqet bazë të shkëlqyer e cila duhet të mbindërtohet.**

Nga analizimi i pavarësisë dhe objektivitetit të organeve të jurisprudencës në Komunën e Strumicës, ka arsye për shqetësim sa i përket pavarësisë dhe transparencës së sistemit të jurisprudencës në Republikën e Maqedonisë. Perceptimi tek qytetarët është se politika ka influencë mbi pavarësinë e organeve të jurisprudencës. Në bazë të të dhënave lidhur me këtë çështje, me siguri të plotë mund të themi se politika, sipas qytetarëve, e ka fjalën kryesore sa i përket pavarësisë dhe në këtë kontekst duhet të punohet seriozisht. Tek qytetarët, gjithashtu, vërehet shkallë e lartë e mosbesimit kur bëhet fjalë për organet e jurisprudencës dhe mekanizmat e organeve të jurisprudencës në Komunën e Strumicës. Krahas ndikimit politik është i pranishëm edhe ndikimi nga biznes elita dhe personat me influencë shoqërore.

Marrë në përgjithësi, pjesa e buxhetit gjyqësor, e cila i akordohet Gjykatës Themelore Strumicë është mjaft e vogël dhe shkakton implikime mbi pavarësinë e vet Gjykatës.

Në mënyrë që të përmirësohet gjendja, Gjykata me konsekuencë duhet t'i zbatojë standardet evropiane për gjyqësor të pavarur, si dhe garancinë për të drejtat e njeriut, të theksuara dhe të garantuara me marrëveshjet ndërkombëtare. Theksi duhet të vihet mbi pozitën e pavarur të gjyqtarit: aq sa është ai i lirë dhe i pavarur, e njëjta rezulton me një gjyqësor të pavarur. Duhet të punohet në drejtim të përforcimit të ndërgjegjësimit të vet gjyqtarëve dhe ata vet të luftojnë për vendin i cili u përket, në përputhje me përcaktimet e Kushtetutës dhe aktet normative pozitive.

Një segment tejet i rëndësishëm është publiciteti i punës së gjyqësorit, në kuptimin e vlerave dhe parimeve të llogaridhënies dhe transparencës. Nevojitet një përfshirje më e madhe e publikut, e cila do të kontribuojë për kontroll më të madh në punën e gjykatave, ndërkaq kjo do të ndikojë edhe mbi pavarësinë e saj dhe cilësinë e vendimeve.

Po ashtu, nevojitet zbatim i plotë i kritereve ekzistues të cilët mundësojnë cilësi në përzgjedhjen dhe avancimin e gjyqtarëve dhe inkorporimin e kritereve shtesë për realizimin e qëllimeve për gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm.

## Shoqata e Punonjësve Financiarë të Vetëqeverisjes Lokale dhe Ndërmarrjeve Publike



### “Burimet e financimit, lartësia e mjeteve të siguruara dhe ndikimi i tyre mbi pavarësinë e pushtetit gjyqësor”

Shoqata e Punonjësve Financiarë të Vetëqeverisjes Lokale dhe Ndërmarrjeve Publike, në periudhën kohore nga muaji nëntor 2014 deri në muajin prill të vitit 2015, e zbatoi Projektin: “Burimet e financimit, lartësia e mjeteve të siguruara dhe ndikimi i tyre mbi pavarësinë e pushtetit gjyqësor”.

Qëllimi i projektit ishte hulumtimi i shkallës së efektivitetit dhe efikasitetit të pushtetit gjyqësor, përmes:

- hulumtimit të nivelit të mjeteve të nevojshme financiare të pasqyruara nga gjykatat objekt të evaluimit
- përcaktimit të mjeteve të miratuara financiare
- vlerësimit të mënyrës së shpërndarjes së mjeteve të pushtetit gjyqësor deri tek shfrytëzuesit e fundit
- dhënies së rekomandimeve për tejkalimin e gjendjeve të konstatuara

Së këtëjmi, janë zbatuar aktivitetet si vijojnë:

1. Grumbullimi i informatave dhe të dhënave (publikime dhe analiza)
2. Analizë e gjendjeve para fillimit të hulumtimit
3. Raporte për progresin e Republikës së Maqedonisë.
4. U përpilua pyetësor anketues për përcaktimin e: Procesit të buxhetimit në gjykatat e përzgjedhura; Mjeteve të planifikuara dhe të siguruara financiare në periudhën për të cilën ka të bëjë hulumtimi

Pyetësori u shpërnda në 5 gjykata themelore, ndërkaq përgjigje kthyesë u pranuan nga 2 gjykata themelore.

5. Intervista me persona udhëheqës në gjykatat e përzgjedhura:
  - U realizua intervistë vetëm me u.d. kryetarin e KGJB dhe Ministrin e Drejtësisë edhe pse u planifikuan intervista me udhëheqës të përzgjedhur (përfaqësues) nga target grupi.
  - Për shkak të problemeve, sa i përket pranimit të informatave të nevojshme, në vend të intervistave formale u realizuan intervista

joformale me persona të cilët janë të njoftuar me gjendjet në fushën e analizuar.

6. Grumbullimi, përpunimi dhe analiza e të dhënave dhe informatave të siguruar – janë siguruar raportet e publikuara vjetore, të publikuara në ueb-faqet e gjykatave të përzgjedhura dhe në faqen e Këshillit Gjyqësor, si dhe me:
- Kërkesë për informata të karakterit publik, dërguar në 3 gjykata;
  - Formularë të siguruar nga Regjistri Qendror – Pasqyrë e të dhënave nga llogaria vjetore për gjykatat e përzgjedhura lidhur me periudhat raportuese të vitit 2010, 2011, 2012 dhe 2013.

#### **Rezultatet e fituara – prezantimi i gjendjeve:**

- Mjetet e planifikuara/realizuara për pushtetin gjyqësor nuk e tejkalojnë shumën prej 0,38% të bruto prodhimit vjetor (BPV), e që shpie në konstatimin se akoma nuk është arritur niveli i përcaktuar ligjor prej 0,8% të BPV. Këto mjete të miratuara të gjykatave nuk i përmbushin nevojat për funksionimin e tyre normal.
- Mjetet e akorduara nuk mjaftojnë për aktivitetin e tyre e që ndikon mbi punën normale të pushtetit gjyqësor, cenimin e besimit të kreditorëve dhe në përgjithësi sa i përket reputacionit të pushtetit gjyqësor.
- Gjykatat kanë detyrime të pashlyera, ndërkaq çrregullohet aftësia e pagesës së disa gjykatave. Vërehet një rast karakteristik tek një gjykatë – në raste të caktuara shlyerjen e detyrimeve e bën me vonesë prej 398 ditësh.
- Është e pranishme dukuria e bllokimit të llogarisë së transaksionit të disa gjykatave për shkak të shlyerjes jo me rregull të detyrimeve;
- Në strukturën e shpenzimeve vend dominant kanë pagat, pastaj mallrat dhe shërbimet, ndërkaq një vend të papërfillshëm ose të pakonsiderueshëm e zënë shpenzimet kapitale.
- Në pjesën e strukturës së detyrimeve të pashlyera vend dominant zënë shërbimet kontraktuese dhe shërbimet komunale.
- Në kontinuitet barten edhe detyrime të pashlyera që kanë të bëjnë me detyrime për mjekimin e personave të paraburgosur, si dhe detyrime për mbrojtës të angazhuar sipas detyrës zyrtare (avokat), e që mund të ketë ose ka ndikim mbi të drejtat e personave të caktuar, pavarësisht se cilit institucion në të ardhmen do t'i delegohen këto kompetenca.

#### **Rekomandime për tejkalimin e gjendjeve:**

- Buxhet ideal gjyqësor do të ishte ai i cili do të kapte shumën jo më pak se 0,5% të Buxhetit të RM-së, me të cilin do të përmbusheshin nevojat aktuale të gjyqësorit sa u përket mjeteve financiare. Për një financim të përhershëm pa pengesa të aktiviteteve rrjedhëse, detyrimeve të maturuara dhe nevojave investuese të gjyqësorit, nevojitet të realizohet buxheti gjyqësor republikan në madhësinë e përcaktuar ligjore prej më së paku 0,8% nga BPV i RM-së.

- Rekomandohet rritja e pjesës së mjeteve që do të shfrytëzohen për financimin e aktiviteteve investuese në gjykata.
- Rekomandohet të bëhet harmonizimi i kërkesave buxhetore të gjykatave – njësive buxhetore në nivel të juridiksionit të apelit.
- Në funksion të përcaktimit më preciz të mjeteve të nevojshme financiare dhe formimit të planit real financiar (kërkesë buxhetore), duhet të avancohet modeli ekzistues për përlllogaritjen e kostos së çmimit të lëndës gjyqësore.
- Në funksion të efektivitetit dhe efikasitetit në shpenzimin e mjeteve buxhetore dhe kryerjes së punëve sipas rregullave të përcaktuara dhe me respektimin e normave etike të sjelljes, duhet të përforcohet sistemi i kontrollit të brendshëm nëpër gjykata.
- Të përforcohen kapacitetet për menaxhimin financiar në gjykata.

## OJQ Infoqendra - Shkup



### НВО ИНФОЦЕНТАР

#### “Cili është çmimi i lirisë së shprehjes në Maqedoni?”

OJQ Infoqendra, në partneritet me Qendrën për Zhvillimin e Mediave, zhvilloi hulumtim në kontekst të Ligjit për përgjegjësi civile nga ofendimi dhe shpifja, të titulluar si: “Cili është çmimi i lirisë së shprehjes në Maqedoni?”

Me këtë hulumtim janë përfshirë rastet gjyqësore sipas Ligjit për përgjegjësi civile për ofendim dhe shpifje në 9 gjykata themelore: Gostivar, Tetovë, Shtip, Veles, Manastir, Prilep, Strumicë, Kumanovë dhe Shkupi 2, si dhe qëndrimet dhe përvojat e aktivistëve civilë, gazetarëve, gjyqtarëve dhe ekspertëve për të drejtat e njeriut.

Nga hyrja në fuqi e Ligjit për përgjegjësi civile për ofendim dhe shpifje, para gjykatave themelore janë ngritur gjithsej 520 procese gjyqësore, prej të cilave 74,4% tanimë kanë përfunduar, ndërsa 25,6% e procedurave gjyqësore akoma janë në rrjedhë e sipër.

“Shtiza e lirisë së shprehjes më së shpeshti thyhet para Gjykatës Themelore Shkupi 2 – Shkup. Numri më i madh i procedurave gjyqësore për ofendim dhe shpifje zhvillohen pikërisht në këtë Gjykatë dhe ato përfshijnë përafërsisht dy të tretën e numrit të përgjithshëm të rasteve gjyqësore, të përfshira në këtë analizë. Madje një e treta e procedurave të zhvilluara në gjykatën e Shkupit, kanë të bëjnë me procese në të cilat si palë paraqiten gazetarë, punëtorë mediatikë, ose media.

Praktika e deritanishme, por edhe analiza e aktgjykimeve të miratuara të plotfuqishme, tregojnë se ekziston dallim drastik shqetësues në punën e gjykatës, kur bëhet fjalë për procese në të cilat si palë paraqiten politikanë/funksionarë shtetërorë, kundrejt rasteve në të cilët ata nuk janë të involvuar as si paditës, e as si të paditur.

Në rastet kur njëra nga palët është funksionar shtetëror, përkatësisht politikan, është evidente se të njëjtat zhvillohen më shpejtë, përkatësisht është e dukshme tendenca për veprim emergjent të gjykatës. Nga ana tjetër, në raste të këtilla zbatimi i Konventës Evropiane dhe Praktikës së Strasburgut, e cila mes tjerash parashikon që titullarët e funksioneve publike të kenë një prag më të lartë të tolerancës sa u përket kritikave, është jokonsekuente dhe është në drejtim të mbrojtjes së plotë të nderit dhe reputacionit të funksionarit kundrejt lirisë së shprehjes.

Standardet e dyfishta gjatë veprimit të gjyqtarëve, mbrojtja plotësisht e pabazuar e nderit dhe reputacionit të funksionarëve dhe mosrespektimi i Konventës Evropiane dhe Praktikës së Gjykatës së Strasburgut, në mënyrë serioze i kanosen lirisë së shprehjes në Maqedoni, çojnë në vet-censurim, shkaktojnë efekte të ftohjes ndaj gazetarisë investigative dhe seriozisht e imponojnë çështjen e (pa) varësisë së pushtetit gjyqësor në shtet.



Aktivistët, gazetarët dhe ekspertët për të drejtat e njeriut thuaja se janë unanim në konstatimin se në Maqedoni, liria e shprehjes është rrezikuar seriozisht dhe se njerëzit të cilët kanë qasje kritike ndaj pushtetit dhe politikave të tij, si në nivel nacional - ashtu edhe në atë lokal, thuaja se vazhdimisht dhe gjithnjë e më shumë janë të ekspozuar në presione, kërcënime dhe frikësime të llojeve të ndryshme.

Aktivistët dhe ekspertët për të drejtat e njeriut, veçanërisht ata që jetojnë dhe punojnë në Shkup, më së shpeshti ballafaqohen me komplete të vazhdueshme publike edhe atë nga ana e mediave pro-qeveritare, rrjeteve sociale por edhe nga ana e përfaqësuesve të pushtetit dhe partive në pushtet. Aktivistët, kryesisht ata të cilët jetojnë në mjedise jashtë Shkupit, ballafaqohen edhe me forma të tjera të presioneve, të cilat nuk janë edhe aq të dukshme, megjithatë janë shumë të fuqishme, shqetësuese dhe frikësuese, si për shembull, mesazhe kërcënuese, kërcënime se ndonjë anëtar i familjes do e humbas punën, kontrole inspektuese etj. Njëkohësisht, aktivistët nuk ndihen të sigurt dhe të mbrojtur. Së këtëjmi, siç prononcohen, ka situata në të cilat vet-censurohen dhe e “matin” çdo fjalë të thënë publikisht.

Gazetarët thuaja se janë unanim në atë se cak i vazhdueshëm i presioneve nga ana e pushtetit edhe në nivel lokal edhe në atë nacional, por edhe nga ana e pronarëve të mediave për të cilat punojnë, si dhe me atë se pozita e tyre ekonomike dhe sociale gjithnjë e më shumë vështirësohet dhe përkeqësohet. Një pjesë e madhe e gazetarëve, në nivel lokal, nuk ndihen të mbrojtur as nga redaktorët e tyre dhe as nga pronarët e mediave. Gjendja e këtillë është krejtësisht demotivuese dhe pashmangshëm shpie në vet-censurë dhe në reduktim dramatik të profesionalizmit në gazetari.

Sipas ekspertëve për të drejtat e njeriut, Ligji për përgjegjësi civile për ofendim dhe shpifje nuk siguroi mbrojtje më të madhe sa i përket lirisë së shprehjes në Republikën e Maqedonisë. Dekriminalizimi i ofendimit dhe shpifjes gjithsesi se është një hap pozitiv, megjithatë ai nuk mundësoi liri më të madhe sa i përket gjuhës dhe çlirimit nga vet-censura dhe censura tek gazetarët.



## Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatikë



### “Mediat, pronarët, gazetarët dhe të drejtat e punëtorëve”

Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatikë zbatoi studime të rastit, të cilat i shpalli në publikimin “Mediat, pronarët, gazetarët dhe të drejtat e punëtorëve”. Me studimet janë përfshirë temat si vijojnë:

- Korrupsioni sistematik në mediat maqedonase
- Organizimi sindikalist në media
- Rasti i pesë gazetarëve të përjashtuar nga “Utrinski vesnik”
- Rasti “Alfa TV”

Përveç publikimit, në kuadër të Projektit u projektua edhe filmi dokumentar me titullin e njëjtë<sup>2</sup>

Si dy shtylla kryesore për korrupsionin sistematik në mediat maqedonase, Analiza i thekson: struktura pronësore e mediave dhe reklamata qeveritare. U prezantuan prova për lidhjet e ngushta të pushtetit me pronarët e mediave, veçanërisht të televizioneve, të cilët janë burimi më i shpeshtë i informimit të qytetarëve. Edhe përkrah ndërrimit të pronarëve, në disa media në mënyrë që nga aspekti formal të përmbushen kërkesat ligjore, në të vërtetë në aspekt esencial asgjë nuk ka ndryshuar. Qeveria, madje në vitin 2014, pas shumë presioneve, i publikoi të dhënat për reklamata qeveritare (por vetëm për periudhën kohore nga viti 2012). Kriterin që e thekson Qeveria për shpërndarjen e mjeteve nga fushatat qeveritare në media – rejtingu – nuk është respektuar, ndërkaq çmimet e reklamimit janë palogjikshëm të ulëta. Përveç kësaj është prezantuar edhe rrjedha e ngjarjeve (ndryshime të ligjeve, ndryshime institucionale), përmes të cilave Qeveria realizoi ndikim kyç mbi trupat rregullator – Agjencia e Mediave dhe Agjencia e Shërbimeve Audio Vizive, si dhe në Radio Televizionin e Maqedonisë.

Përmes një sërë provash dhe dëshmish të gazetarëve, studimet e rastit e dëshmojnë presionin sistematikë ndaj gazetarëve edhe atë, para së gjithash, ndaj atyre me më shumë përvojë. Kjo është veçanërisht karakteristike për redaksitë të cilat e kanë ndërruar strukturën pronësore. Përmes dëshmive në këtë publikim dhe përmes deklaratave në filmin dokumentar, gazetarët dëshmojnë për presionet që u bëhen atyre – si në aspekt të lirisë së shprehjes dhe profesionalizimit të gazetarëve, ashtu edhe në aspekt të të drejtave të tyre punëtorë.

“Punë me pseudonime, honoraristë, mbyllja e syve para realitetit dhe qasja selektive e organeve të inspektimit, krijojnë një armatë të gazetarëve plotësisht të pambrojtur dhe punonjësve të eksploatuar mediatikë... Karakteristikë kryesore e këtij grupimi mediatik është pagesa e vogël, puna jashtë orarit, mospagesa e kurrfarë kontributeve, me një fjalë – një pasiguri e plotë sociale dhe ekzistenciale, apo nëse dëshironi ndryshe – klithje e heshtur”.<sup>3</sup>

<sup>2</sup><http://ssnm.org.mk/mediumi-gazdi-novinari-i-rabotnichki-prava-dokumentaren-film/>

<sup>3</sup> Ibid.

Para gjykatave maqedonase janë zhvilluar ose zhvillohen më shumë procedura në lidhje me përjashtimin e gazetarëve. Nga aktgjykimet e lëndëve të deritanishme nuk mund të përcaktohet konsekuencë në praktikën gjyqësore. Përveç kësaj, lëndë të cilat sipas ligjit duhet të jenë të karakterit me procedurë urgjente (gjashtë muaj për konteste pune) zvarriten me vite.

Nga Projekti rezultuan rekomandimet si vijojnë:

- Zgjidhja e korrupsionit sistematik në mediat përmes zgjidhjeve më të mira ligjore për pronësinë e mediave.
- Ndryshim të kornizës ligjore, me të cilën do të mund të kufizohet sponsorimi i shtetit ndaj mediave në formën e reklamave qeveritare.
- Vendosja e kontrollit dhe mobilizimit demokratik mbi institucionet dhe organet kompetente të ngarkuara për zbatimin e Ligjit për media.
- Ristrukturimi i Agjencisë për Shërbime Audio Vizive dhe Radio Televizionit Maqedonas, për të cilën do të vendoset në mënyrë deliberative midis të gjitha palëve të interesuara.
- Monitorim të raporteve ndërkombëtare, si indikatorë për harmonizimin e strategjive për përmirësimin e lirisë së gjuhës dhe të drejtave të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë.
- Respektimi i të gjitha konventave dhe deklaratave ndërkombëtare, të nënshkruara nga Republika e Maqedonisë, si dhe respektimi i Kushtetutës dhe ligjeve nga institucionet e shtetit dhe nga pronarët e mediave.
- Krijimi i marrëveshjes kolektive e cila në të ardhmen do të shërbejë si instrument për negociata dhe si një instrument demokratik për përmirësimin e të drejtave të punëtorëve në sektorin mediatik, përmes:
  - Zgjidhjes së problemit të punonjësve me honorarë dhe punës me pseudonime.
  - Zgjidhjes së problemit me punën e papaguar pas orarit të punës.
  - Zgjidhjes së problemit me pushimet mjekësore dhe pushimet vjetore.
  - Zgjidhjes së problemit me mobingun, vendimet e pabazuara për përjashtim nga puna dhe vonesën e pagave.
  - Rritjes së transparencës së punës së medias dhe rritjes së bashkëpunimit midis pronarëve dhe punonjësve.
  - Zgjidhjes së problemit me statusin e punonjësve mediatik në mediat e reja (onlajn).
  - Reduktimit të ndikimit të elitave politike dhe biznes elitave në politikën redaktuese të mediave.
- Rritja e funksionalitetit të Inspektoratit të Punës dhe mbrojtja e punëtorëve nga ana e institucioneve, me qëllim të realizimit të së drejtës kushtetuese për themelimin dhe anëtarësimin në sindikatë.
- Në aspekt të përforcimit të sindikatës dhe fuqisë së gazetarëve dhe punonjësve mediatikë:
  - Përmirësimi i bashkëpunimit të sindikatës me fondacionet, organizatat joqeveritare dhe organizatat aktiviste në Republikën e Maqedonisë.

- Lidhja në rrjet e sindikatave në Republikën e Maqedonisë me sindikatat ndërkombëtare, para së gjithash me sindikatat nga Bashkimi Evropian me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe mbështetjes solidare.
- Rritja e numrit të analizave profesionale dhe literaturës në lidhje me të drejtat e punëtorëve në Republikën e Maqedonisë.
- Përforcimi i kapacitetit të sindikatave përmes ristrukturimit dhe ndryshimit të formave të vjetra pasive me forma të reja të veprimit të artikuluar dhe proaktiv.

## Koalicioni “Të Drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Bashkësive të Margjinalizuara”



### Analizë e mekanizmave për mbrojtjen nga diskriminimi të bashkësive të marginalizuara në nivel lokal: Komuna e Manastirit, Komuna e Strumicës dhe Komuna Qendër

Funksionimi i mekanizmave për mbrojtje nga diskriminimi është kryesor për sigurimin e mbrojtjes nga diskriminimi në të gjitha nivelet. Praktika dhe aktivitetet e deritanishme të organizatave qytetare vë në pah se mungojnë të dhëna për funksionimin e mekanizmave për mbrojtje nga diskriminimi në nivel lokal, bashkëpunimin e tyre të ndërsjellë dhe bashkëpunimin me sektorin civil.

Qëllimi i Analizës është të hulumtohet funksionimi i mekanizmave për mbrojtjen nga diskriminimi në nivel lokal, si dhe shkalla e mbrojtjes së të drejtës për mundësi të barabarta dhe mosdiskriminim të bashkësive të marginalizuara (njerëz të cilët përdorin droga, punëtorët seksual, njerëzit të cilët jetojnë me HIV dhe njerëzit LGBTI). Qëllim plotësues i Analizës është rritja e bashkëpunimit me shoqatat lokale të qytetarëve, të cilat punojnë me bashkësitë e marginalizuara dhe institucionet lokale të cilët e kanë mandatin për mbrojtje nga diskriminimi.

Analiza ofron një pasqyrë të kornizës juridike, përmes desktop analizës së zbatuar të Ligjit për vetëqeverisje lokale, Ligjit për mundësi të barabarta të femrave dhe meshkujve (LMBFM), Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe Ligjin për Avokatin e Popullit, si dhe të statuteve, rregulloreve dhe dokumenteve të tjera strategjike të komunave. Pastaj, u realizuan diskutime me fokus grupe me punëtorë seksual, me njerëz të cilët përdorin droga, me njerëz LGBTI, ndërkaq vetëm në Komunën Qendër u realizua debat edhe me fokus grupin e njerëzve të cilët jetojnë me HIV. Për përpilimin e Analizës u zbatuan edhe intervista me përfaqësues të institucioneve për mbrojtje nga diskriminimi në nivel lokal (me zëvendësit e Avokatit të Popullit në Strumicë dhe Manastir, me kryetarët e komisioneve për mundësi të barabarta dhe me koordinatorët për mundësi të barabarta) dhe me përfaqësues të shoqatave të cilat punojnë me bashkësitë e marginalizuara.

Nga analiza e zbatuar, mes tjerash, mund të konkludohet se mekanizmat e mbrojtjes nga diskriminimi në nivel lokal ballafaqohen me një sërë sfidash. Ligji i ri për LMBFM e imponon detyrimin për komisionet lokale për mundësi të barabarta të zbatojnë aktivitete për mbrojtje nga diskriminimi, megjithatë nuk është parashikuar mënyra dhe forma se si do të realizohet kjo kompetencë. Zëvendësit e Avokatit të Popullit në Manastir dhe Strumicë nuk kanë kompetencë të vendosin për mbrojtje nga diskriminimi, me ç'rast bashkësitë e marginalizuara në nivel lokal thuaja se nuk e denoncojnë diskriminimin. Edhe pse bashkësitë e marginalizuara në të tri komunat

janë viktime të shpeshta të diskriminimit, mbrojtjen që e ofrojnë mekanizmat ekzistues janë joefikas.

Së këtejmi, duhet të përforcohet pozita e koordinatorit për mundësi të barabarta të femrave dhe meshkujve në të gjitha komunat përmes miratimit të aktit për sistematizim, me të cilin do të përcaktohen kompetencat e koordinatorit. Gjithashtu, duhet të akordohen mjete financiare për punën e koordinatorit dhe për zbatimin e aktiviteteve për promovimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Është e domosdoshme të ndërtohen kapacitetet e anëtarëve të komisioneve për mundësi të barabarta midis femrave dhe meshkujve dhe Zyrës së Avokatit të Popullit për nevojat specifike lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi të bashkësive të marginalizuara. Në mënyrë specifike për Komunën e Manastirit rekomandohet zbatimi i Plan Veprimit për qëndrueshmërinë e programeve për HIV dhe tuberkulozë (01 Janar 2014 - 31 Dhjetor 2016), vlerësim i efekteve nga plani i zbatuar dhe vazhdimi i aktiviteteve. Për të tria komunat rekomandohet rritja e numrit të parashtresave deri te Avokati i Popullit përmes motivimit të bashkësive të marginalizuara dhe ofrimit të ndihmës juridike falas. Meqë bashkësitë e marginalizuara në të gjitha komunat kanë qenë viktime të diskriminimit dhe shqetësimit në shkolla, secila nga komunat duhet urgjentisht të ndërmerr masa për eliminimin e shqetësimit homofobik nëpër shkolla. Për Komunën e Strumicës, mes tjerash, rekomandohet të formalizohet ndihma periodike e deritanishme nga ana e Komunës për bashkësi të caktuara të marginalizuara dhe përfshirjen e shoqatave dhe bashkësive të marginalizuara në punën e Komunës përmes iniciativave të tyre. Për Komunën Qendër, mes tjerash, rekomandohet miratimi i dokumentit për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve për mbrojtje nga diskriminimi të bashkësive të marginalizuara.

## Koalicioni “Të Gjithë për Gjykim të Drejtë”



### Monitorimi i implementimit të standardeve ndërkombëtare për gjykim të ndershëm dhe të drejtë

#### **HYRJE DHE METODOLOGJIA E HULUMTIMIT**

Misioni themelor i Koalicionit ka të bëjë me respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, veçanërisht të standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë.

Koalicioni të Gjithë për Gjykim të Drejtë, përmes monitorimit të një numri të caktuar të lëndëve, në procedurën civile dhe penale nga ana e monitoruesve të kualifikuar dhe të pavarur, përgatiti analizë për implementimin e standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë me tregues konkret statistikor.

#### **QËLLIMET DHE METODAT E HULUMTIMIT**

Në hulumtim u zbatuan metodat e monitorimit dhe u përpilua instrumenti - pyetësor.

Periodha e monitorimit përfundoi me 54 lëndë (45 penale dhe 9 lëndë civile), ndërkaq monitorimi u zbatua nga 3 monitorues të trajnuar, një jurist i diplomuar dhe dy juriste të diplomuara, të cilët morën pjesë në seanca dhe drejtpërsëdrejti i grumbulluan të dhënat.

Monitoruesit/et në çdo seancë e plotësonin pyetësorin, i cili përbëhet nga 82 pyetje, të ndara në disa kapituj, me qëllim që të analizohet zbatimi i ligjeve në gjykatë, implementimi i standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejtë, pyetje për procedurën e provave etj.

Standardet për gjykim të ndershëm dhe të drejtë, të cilët ishin objekt të observimit në këtë Projekt, në përputhje me standardet ndërkombëtare, kanë të bëjnë me:

- Të drejtën e gjykatës së pavarur dhe të paanshme (neni 6 KEDNJ)
- Të drejtën e gjyimit brenda afatit të arsyeshëm (KEDNJ) dhe risinë e parashikuar me Ligjin për gjykatat, me të cilin u inkorporua mjeti juridik Padi para Gjykatës Supreme për mbrojtjen e të drejtës së gjyimit brenda afatit të arsyeshëm.
- Barazia e armëve, përkatësisht mundësi të barabarta për palët në prezantimin e provave, si dhe trajtim i barabartë nga ana e gjykatës. Në procedurat penale barazia e armës është garanci për të drejtën e mbrojtjes. Parimi kërkon kohë të mjaftueshme, si dhe mundësi për përgatitjen e mbrojtjes, të drejtën e mbrojtësit, të drejtën të propozohen dhe t'i parashtrohen pyetje dëshmitarëve dhe të drejtën e të pandehurit të jetë i pranishëm gjatë kohës së gjyimit.

Shkelja e parimit do të ndodhë nëse i pandehuri nuk merr informata të cilat janë të nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes.

- Parimi i gjykimit publik para tribunalit të paanshëm (neni 6 i KEDNJ)
- Prezumimi i pafajësisë, i parashikuar në nenin 6, pikën 2 të KEDNJ, në Kushtetutën e RM-së dhe si parim kryesor i LPP.

### **PIKËPAMJE PËRFUNDIMTARE**

- Nuk mund të nxirret konkluzion përfundimtar sa i përket çështjes së gjykimit të ndershëm dhe të drejtë, gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, sepse monitorimi i përfshiu lëndët të cilat tashmë kishin filluar ndërsa një pjesë e tyre nuk përfunduan pas monitorimit.
- Gjykatat në përgjithësi në mënyrë të paanshme dhe profesionale e kryenin funksionin e tyre, në asnjë rast nuk ka pasur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit.
- Në 3 raste, mbrojtja është ankuar se nuk ka pasur qasje deri te të gjitha provat, ndërsa në 1 rast nuk u janë dërguar provat.
- Në pjesën më të madhe gjykimet kanë qenë publike, përkatësisht 48 raste janë zhvilluar publikisht, ndërsa në 6 raste nuk është vërejtur nëse gjykimi ka qenë publik. Por, në 15 raste vendi dhe koha e gjykimit nuk është shpallur publikisht.
- U konstatua se gjykata i ka respektuar të drejtat e personave të pandehur, ka siguruar përktim, në rast se ka qenë e nevojshme, personat e pandehur janë pyetur nëse e dinë se pse janë akuzuar, por vetëm në 15 raste janë njoftuar me mundësinë e ndihmës juridike falas. Këto shifra, në shikim të parë, janë tejet të vogla, por nëse përkthehen në përqindje, 4 raste nga 45 lëndë janë thuaja se 10% dhe kjo është alarmante.
- Vërejtje themelore në kontestet civile është prolongimi i seancave për shkak të mungesës së palëve, e që shkaktohet nga dërgesa e parregullt.

### **REKOMANDIME**

- Monitorimi i lëndëve për përfshirjen e të gjitha fazave, me qëllim të vlerësimit të plotë të zbatimit të standardeve për gjykim të ndershëm dhe të drejtë.
- Respektimi i parimit të prezumimit të pafajësisë, duke e përfshirë garancinë e përforcuar dhe mekanizmin kontrollues në rast të cenimit të së njëjtit, përkatësisht obligimin e detyrueshëm të gjyqtarëve që të reagojnë gjatë cenimit të kësaj të drejte.
- Publikimi i vendit dhe kohës së gjykimit, me qëllim të përmbushjes së standardeve për gjykim të ndershëm dhe të drejtë.
- Gjykata duhet t'i shfrytëzojë të gjitha mekanizmat të cilët i parashikon ligji për zbatimin e dërgesës së rregullt, ndërsa personat të cilët janë në paraburgim detyrimisht të dërgohen me shoqërim, me qëllim të shmangies së prolongimit të seancave gjyqësore për procedurat e lëndëve për të cilat veprohet me urgjencë.

- Gjykatat të kontrollojnë nëse personi i pandehur është i aftë financiarisht për t'i mbuluar shpenzimet e mbrojtjes dhe t'i udhëzojnë/mësojnë për mundësinë e ndihmës juridike falas.
- Sigurimi i kohës së mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes të të pandehurit gjatë gjithë procedurës, ndërkaq veçanërisht gjatë përgatitjes së seancës kryesore, me mundësimin e qasjes deri te provat dhe respektimin e barazisë së armëve në procedurë.
- Inkorporimi i mjetit juridik, me qëllim të kufizimit të qasjes deri tek provat, si dhe mekanizmi për kontestimin e cilësisë së përkthimit, i cili është esencial në realizimin e të drejtës së mbrojtjes.



## Shoqata Qendra për Strategji dhe Zhvillim PAKTIS – Prilep



### Sistemi i masave alternative, me vështrim të veçantë mbi gjendjen e implementimit në Komunën e Prilepit

Në kuadër të “Rrjetit 23”, Shoqata Qendra për Strategji dhe Zhvillim PAKTIS – Prilep, në periudhën gjashtëmujore e zbatoi Projektin – Sistemi i masave alternative, me vështrim të veçantë mbi implementimin e tyre në Komunën e Prilepit. Qëllimi i Projektit ishte të arrihet stimulimi i masave jo me burg, të cilat sigurojnë ekuilibrin midis të drejtave të kryerësit, të drejtave të viktimës dhe interesit të shoqërisë, përkatësisht dënimi me burg të zbatohet si mjet i fundit. Në mënyrë plotësuese, përmes aktiviteteve të Shoqatës të aktualizohet problematika e masave alternative dhe funksionimi i sistemit ndëshkues-korrektues në shtet, si dhe informimi i publikut ekspert dhe më të gjerë për gjendjen e implementimit të masave alternative, rolin dhe qëllimin e tyre. Interesi për hulumtimin e kësaj teme u nxitë nga gjendjet alarmante në burgjet e Republikës së Maqedonisë, ku si probleme të përgjithshme potencohen mbipopullimi, tortura, qasja johumane dhe degraduese ndaj të burgosurve, kushtet e pavolitshme materiale, mungesa e çdo lloj regjimi, menaxhimi joprofesional, mbrojtja joadekuate shëndetësore dhe mungesa e kontrollit dhe mbikëqyrjes. Në përgjithësi, gjendja e këtillë është potencuar çdo vit në raportet e Komisionit Evropian për progresin e Republikës së Maqedonisë, në Kapitullin 23 – Jurisprudenca dhe Të Drejtat Themelore, në pjesën e të drejtave themelore. Së këtejmi, me rëndësi të veçantë është nevoja e implementimit përkatës të masave alternative, e cila drejtpërsëdrejti do të ndikojë mbi reduktimin e mbipopullimit dhe përmirësimit të kushteve në burgje, ndërsa njëkohësisht edhe nevoja për përmirësimin e efikasitetit të gjyqësorit lidhur me shqiptimin e dënimeve përkatëse, të cilat do ta arrijnë qëllimin e ndëshkimit, e që do të rezultojë me përmirësimin e qasjes së politikës ndëshkuese në reduktimin e kriminalitetit në Republikën e Maqedonisë.

Metodologjia e hulumtimit përfshiu: intervista me përfaqësues të institucioneve, anketa të opinionit ekspert, analiza të raporteve të institucioneve dhe analiza të praktikës gjyqësore.

Nga hulumtimet e zbatuara, mund të konstatojmë se është e lartë shkalla e zbatimit të dënimeve me burgim, prej të cilave është e lartë përqindja e dënimeve me burgim me kohëzgjatje të shkurtër. Në vijim jepen të dhënat statistikore të dënimeve të shqiptuara me burgim dhe përfaqësimi në përqindje i dënimeve me kohëzgjatje të shkurtër.<sup>4</sup>

<sup>4</sup>Publikime – “Kryerës të veprave penale” për vitet 2007 – 2013, i aksesshëm në: <http://www.stat.gov.mk/PublikaciiPoOblast.aspx?id=43&rbrObl=6>

Viti	Gjithsej dënime me burgim	Dënim me burgim deri në 6 muaj	Përqindja
2009	2808	1065	37,9%
2010	2596	693	26,6%
2011	3020	1230	40,7%
2012	2807	1206	42,9%
2013	3064	1148	37,4%

Nga pasqyra, përveç që mund të vërejmë rritje të shqiptimit të dënimeve me burgim, me numër më të madh në vitin 2012, veçanërisht shqetëson fakti se gjatë tre viteve të fundit është e lartë shkalla e dënimeve të shqiptuara me kohëzgjatje të shkurtër edhe atë më shumë se një e treta, përkatësisht deri në 42.9% nga numri i përgjithshëm i dënimeve të shqiptuara me burgim. Gjendja e këtillë vë në dukje se burgjet janë përplot me kryerës të ashtuquajturit kriminalitet “të vogël”, të cilët u nënshtrohen të gjitha rreziqeve të cilat i parashikon dënimi me burgim.

Rrjedhimisht, si pasojë e gjendjeve të lartpërmendura, në RM, ballafaqohemi edhe me numër të madh të recidivistëve.<sup>5</sup>

Viti	Numri i përgjithshëm i kryerësve të veprave penale	Numri i përgjithshëm i të dënuarve me burgim	Recidivistë
2007	9639	2654	1825
2008	9503	2430	1561
2009	9801	2808	1830
2010	9169	2596	1945
2011	9810	3020	2093
2012	9042	2807	1239
2013	9539	3046	1328

Masat alternative janë shprehje e tendencës bashkëkohore për aplikimin restriktiv të dënimit me burgim dhe për trajtimin dhe riintegrimin e kryerësve jashtë burgut. Me Kartën e vitit 2004, në përputhje me rekomandimet e Këshillit të Evropës – Rekomandimi (92) 16 – lidhur me Rregullat Evropiane për Sanksione dhe Masa Alternative të zbatuara në komunitet dhe Rekomandimi (2000) 22 lidhur me

<sup>5</sup> Publikime – “Kryerës të veprave penale” për vitet 2007 – 2013, i aksesshëm në: <http://www.stat.gov.mk/PublikaciiPoOblast.aspx?id=43&rbrObl=6>

përmirësimin e zbatimit të Rregullave Evropiane për Masat dhe Sanksionet, në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë, u inkorporua sistemi i masave alternative me të cilin parashikohet: Dënim me kusht, Dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, Ndërprerje me kusht të procedurës penale, Punë me dobi të përgjithshme shoqërore, Vërejtje gjyqësore dhe Arrest shtëpiak. Në përputhje me Kodin Penal, u përcaktua qëllimi i veçantë i masave alternative, si vijon: *ndaj kryerësit përgjegjës për veprën penale të mos aplikohet dënim për vepra më të lehta kur një gjë e këtillë nuk është e nevojshme për mbrojtje juridiko – penale dhe kur mund të pritet se qëllimi i dënimit mund të realizohet me paralajmërim me kërcënim për dënim (dënim me kusht), vetëm paralajmërim (vërejtje gjyqësore) ose me masën për ndihmë dhe mbikëqyrje, në lidhje me sjelljen e kryerësit në liri.*

Zbatimi i llojeve të masave alternative për periudhën kohore nga viti 2007 deri në vitin 2013:<sup>6</sup>

	Dënime me kusht	Ndërprerje me kusht të procedurës penale	Dënime me kusht me mbikëqyrje të mbrojtur	Punë me dobi të përgjithshme shoqërore	Vërejtje gjyqësore	Arrest shtëpiak
2007	4712	0	0	1	214	0
2008	4877	0	0	0	182	0
2009	4698	0	0	0	180	0
2010	4138	0	0	0	145	0
2011	4241	0	0	0	153	0
2012	3463	0	0	2	130	0
2013	3804	0	0	0	110	0

Nga pasqyra tabelore të të dhënave statistikore, lidhur me zbatimin e llojeve të masave alternative, mund të konkludojmë se krahas inkorporimit të masave të reja alternative në Kodin Penal, prapë se prapë politika ndëshkuese ka të bëjë me shqiptimin e sanksioneve qortuese dhe vërejtjeve sikur në sistemin paraprak, përkatësisht gjyqtarët më së shpeshti shqiptojnë dënime me kusht, ndërsa në numër më të vogël shqiptojnë vërejtje gjyqësore.

Hulumtimi ishte bazë për konkluzionet, si vijojnë:

- Ndërmarrje dhe propozim i pamjaftueshëm i masave për përmirësimin e kushteve për zbatimin e masave alternative nga ana e Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve.

<sup>6</sup> Publikime – “Kryerës të veprave penale” për vitet 2007 – 2013, i aksesshëm në: <http://www.stat.gov.mk/PublikaciiPoOblast.aspx?id=43&rbrObl=6>

- Mosinformim lidhur me gjendjen e implementimit të masave alternative – Drejtoria e anashkalon këtë temë në raportet e saj vjetore.
- Ndihmë e pamjaftueshme profesionale e Drejtorisë ndaj institucioneve të tjera – është organizuar vetëm një punëtori për zbatimin praktik të masave alternative.
- Moskoordinim i Drejtorisë me qendrat për perkujdesje sociale.
- Në lidhje me zbatimin e masës Punë me dobi të përgjithshme shoqërore, përveç në nivel të Qytetit të Shkupit, në qytetet e tjera nuk janë nënshkruar memorandume për bashkëpunim me ndërmarrjet publike.
- Mosndërmarrje e masave – me kohë, lidhur me furnizimin e pajisjes për zbatimin e mbikëqyrjes elektronike për aplikimin e masës Arrest shtëpiak.
- Në Qendrën për Punë Sociale në Prilep, nuk është formuar seksion për zbatimin e masave alternative, e as që ka persona përgjegjës që të punojnë në zbatimin e masave alternative.
- Edhe përkrah miratimit të akteve nënligjore në vitin 2008, siç janë: Rregullorja për kushtet, procedura dhe mënyra e lëshimit dhe heqjes së lejes për zbatimin e masave alternative, Rregullorja për llojin dhe kushtet e zbatimit të punës me dobi të përgjithshme shoqërore dhe Rregullorja për zbatimin e mbikëqyrjes profesionale me instruksion në aplikimin e punës me dobi të përgjithshme shoqërore, megjithatë gjendja sa i përket implementimit të llojeve të masave alternative nuk u përmirësua.
- Në përputhje me nenin 497 të Ligjit për procedurë penale, në propozimin për lëshimin e urdhrit ndëshkues, përveç masës alternative dënim me kusht, llojet e tjera të masave alternative nuk janë parashikuar, që shpie në konkluzionin se roli i prokurorëve publikë është pasiv në marrjen e iniciativave për zbatimin e masave alternative.
- Vetëm në një rast prokurori publik nga PTHP Prilep, në pretencën e tij ka propozuar shqiptimin e masës alternative - punë me dobi të përgjithshme shoqërore.
- Në Gjykatën Themelore Prilep, të dënuarit deri më tani nuk e kanë shfrytëzuar mundësinë e cila konform nenit 58-b, paragrafi 3 të Kodit Penal, të dënuarve të cilëve u është shqiptuar dënimi me para deri në 90 gjoba ditore ose 1.800 euro në kundërvlerë me denarë, ose dënim me burgim deri në tre muaj, të paraqesin kërkesë për zëvendësimin e dënimit me punë me dobi të përgjithshme shoqërore.

Konform analizave të bëra për përmirësimin e implementimit të sistemit të masave alternative i propozojmë rekomandimet, si vijojnë:

- Kontribut aktiv i shtetit dhe institucioneve për afirmim më të madh të sistemit të masave alternative për realizimin e efekteve të plota nga të njëjtat dhe për ngritjen e seriozitetit dhe përgjegjësisë ndaj këtyre sanksioneve.
- Apel deri te gjykatat: dënimi me burgim të përdoret si ultima ratio.

- Informim i rregullt nga ana e institucioneve, veçanërisht nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve – me raporte të veçanta për zbatimin e masave alternative.
- Ndërmarrja e domosdoshme e aktiviteteve për edukimin e të punësuarve në institucionet kompetente lidhur me implementimin e masave alternative.
- Krijimi i supozimeve teknike për zbatimin e masave alternative dhe monitorimin e efekteve që i gjenerojnë.
- Të krijohet sistem në të cilin do të kategorizohen llojet e veprave penale dhe llojet e kryerësve të veprave penale, me ç'rast shqiptimi i masave alternative ka efekt më të madh, e që do ta stimulojë shqiptimin më të madh nga ana e gjyqtarëve.
- Krijimi i sistemit në të cilin do të pasqyrohen të gjitha institucionet, ndërmarrjet dhe organizatat, në të cilat të dënuarit do të mund ta kryejnë punën me dobi të përgjithshme shoqërore.
- Prokuroria të ketë një rol më aktiv lidhur me propozimin e masave alternative, zgjerimin dhe plotësimin e nenit 497 të LPP, të ofrohet mundësia që edhe llojet e tjera të masave alternative të mund të propozohen me propozim për lëshimin e urdhrit ndëshkues.
- Të zgjerohet lista e obligimeve, të cilat mund të shqiptohen bashkë me dënimin me kusht me mbikëqyrje të mbrojtur, me çka do të zgjerohet vëllimi i mundësive për vepra të ndryshme penale dhe për lloje të kryerësve.
- Në raste të caktuara, për vepra më të lehta penale dhe nëse viktimat është e mbrojtur dhe dëmshpërblyer, gjykata edhe recidivistëve të mund t'u shqiptojë punë me dobi të përgjithshme shoqërore, me ç'rast do të realizohet edhe parimi i mosdiskriminimit në lidhje me zbatimin e këtyre masave.
- Zbatim transparent, efikas dhe me kohë të sistemit të ri të inkorporimit të barrës së provës në Republikën e Maqedonisë, në përputhje me Plan Veprimin e parashikuar, me përfshirjen e ekspertëve gjatë gjithë procesit, ndërsa njëkohësisht edhe me monitorim të përforcuar nga ana e sektorit joqeveritar.

## Shoqata për Mundësi të Barabarta “Qasja e Barabartë”



### “Analizë e zbatimit të Ligjit për ndihmë juridike falas, përfshirë edhe analizën (cost-benefit analysis) e shpenzimeve për zbatimin e saj, me theks të veçantë mbi aspektin gjinor”

**Objekt i Analizës** është zbatimi i Ligjit për ndihmë juridike falas (LNJF) dhe Analizës për shpenzimet e zbatimit të tij, me theks mbi aspektin gjinor. Analiza përmban edhe pasqyrë komparative me vendet e rajonit (Mali i Zi, Kroacia dhe Sllovenia). Përmes shqyrtimit të shpenzimeve dhe përfitimeve, analiza i vë në pah mënyrat e mundshme që do të çojnë deri në efikasitetin e saj më të madh.

**Qëllimi i Analizës** është që përmes hulumtimit të sigurohet këqyrje e të drejtës për NJF si mekanizëm që e kanë në dispozicion kategoritë vulnerabile të qytetarëve, veçanërisht femrat të cilat, gjatë realizimit të të drejtave të tyre para gjykatave dhe institucioneve shtetërore, ballafaqohen me barriera dhe/ose lloje të ndryshme të diskriminimit.

Hulumtimi në terren u zbatua në tri komuna: Kumanovë, Tetovë dhe Manastir, qytete multietnike specifike sipas numrit më të madh të kërkesave të paraqitura për ndihmë juridike falas në vitin 2013 dhe 2014, qytete këto në të cilët janë regjistruar shoqata të qytetarëve të cilat ofrojnë ndihmë juridike paraprake. U zbatuan intervista gjysmë të strukturuar me 21 persona: 11 avokatë, 8 gjyqtarë dhe 2 përfaqësues të administratës gjyqësore, u mbajtën 3 fokus grupe në 3 qytetet e përzgjedhur me 35 qytetarë kërkues potencial (femra-viktima të dhunës familjare dhe persona në rrezik social), si dhe u zbatua anketë me 151 qytetarë në lidhje me shkallën e informimit dhe qasjen e qytetarëve deri te e drejta për NJF në të tre qytetet e përzgjedhur. Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve 41% janë meshkuj dhe 59% janë femra.

U bë analiza e përfitimeve dhe shpenzimeve, në kontekst të miratimit të vendimeve ekonomike, me qëllim që të vlerësohet implementimi i Ligjit për ndihmë juridike falas.

Gjatë analizës së shpenzimeve dhe përfitimeve u shfrytëzuan informata financiare me kufizime të caktuara, ndërkaq u morën parasysh vetëm shpenzimet e drejtpërdrejta të Ministrisë së Drejtësisë gjatë implementimit të LNJF (shpërblime për avokatë, kompensim për SHQ të cilat ofrojnë ndihmë juridike paraprake, ditë për ndihmë juridike falas dhe plan të publikuar në shtypin publik).

#### **Nga Analiza rezultuan konkluzionet, si vijojnë:**

- Është i pakontestueshëm ndikimi pozitiv i implementimit të LNJF në nivel individual por edhe në nivel të bashkësisë, megjithatë është kufizuar qasja deri

në realizimin e të drejtës së NJF të qytetarëve për shkak të informatave të pamjaftueshme për ekzistimin e LNJF.

- LNJF nuk siguron qasje të barabartë të qytetarëve deri te institucionet e sistemit dhe nuk mundëson ndihmë juridike efektive për shkak të procedurave të gjata.
- Ekziston mosbesim ndaj gjykatave, sa i përket mënyrës së veprimit të avokatëve.
- Avokatët ballafaqohen me probleme për arkëtimin e shërbimeve që i ofrojnë e që ndikon mbi cilësinë e shërbimit të dhënë.
- Niveli i bashkëpunimit dhe koordinimit midis të gjitha subjekteve të përfshira në sistemin e NJF është i pakënaqshëm.
- Vërehet një edukim i pamjaftueshëm dhe josensitivitet të punonjësve në njësitë rajonale, gjykatat dhe avokatët të cilët janë të ngarkuar për praktikimin e tij.
- Kemi numër të vogël të kërkesave të paraqitura dhe miratuara për LNJF për shkak të mospërputhshmërisë me nevojat e kërkuarve potencial të kësaj të drejte.
- Femrat kanë beneficion më të madh në realizimin e kësaj të drejte e që e vë në pah pozitën e tyre në të cilën gjenden në shoqëri.

#### **Propozohen rekomandimet si vijojnë:**

- Të avancohet koordinimi dhe bashkëpunimi midis subjekteve të përfshira në sistemin e NJF.
- Të intensifikohet promovimi i LNJF, me qëllim të ngritjes së vetëdijes tek qytetarët sa i përket qasjes dhe: mënyrës, kushteve dhe procedurave për realizimin e kësaj të drejte, si dhe përfitimeve që i ofron Ligji për ofruesit e NJF.
- Sigurim më efikas dhe më transparent të qasjes deri te drejtësia të grupeve vulnerable sociale, me theks të veçantë mbi femrat.
- Nevojiten më shumë trajnime për punonjësit në njësitë rajonale, gjyqtarët, avokatët dhe përfaqësuesit e shoqatave të qytetarëve për zbatimin e LNJF.
- Të inkurajohen dhe stimulohen femrat për shfrytëzimin e të drejtës së NJF si për vet ato ashtu edhe për fëmijët e tyre.
- Të sigurohen më shumë mjete nga Buxheti për zbatimin e LNJF.
- Të ngritet iniciativë për ndryshimin dhe plotësimin e LNJF në drejtim të thjeshtimit të procedurave për praktikimin e së drejtës së NJF.

**Konkluzionet dhe rekomandimet u janë adresuar institucioneve kompetente me qëllim të ndërtimit të sistemit më efikas në të cilin qytetarët tërësisht do të**

**mund ta realizojnë të drejtën e qasjes së barabartë deri te drejtësia dhe gjetjen e zgjidhjeve aktive dhe pozitive të orientuara kah përmirësimi i LNJJ.**



## Shoqata Sheshi Liria – Shoqata për Aktivizëm, Teori dhe Art, Shkup



### Rrugët e reja në Shkup dhe të drejtat e liritë themelore nga Karta e BE

Hapësira publike, e rregulluar nga institucionet publike, është manifestim fizik i politikave publike të cilat ato i zbatojnë. Aktet juridike lokale dhe nacionale, të cilat e rregullojnë çështjen e rikonstruksionit të rrugëve, deri diku i promovojnë politikën publike të cilat janë në përputhje me Kartën e Vlerave dhe Lirive Themelore të Bashkimit Evropian, megjithatë gjendja në terren është krejtësisht ndryshe.

Praktika e institucioneve publike, gjatë rikonstruksionit të rrugëve, konsiston me respektimin arbitrar ose të marginalizuar të atyre dispozitave ligjore ose juridike të cilat më së shumti i mbrojnë kategoritë vulnerabile, pjesëmarrës në komunikacion dhe mjedisin jetësor. Çdoherë kur përcaktohet diapazoni i standardeve për respektim, institucionet publike zakonisht i përmbahen minimumit, veçanërisht kur bëhet fjalë për sigurimin e hapësirës, mbrojtjes ose masës për integrimin e këmbësorëve dhe pjesëmarrësve të kategorive vulnerabile në komunikacion.

Sheshi Liria zbatoi hulumtim në terren në 6 rrugë në 3 komuna në Shkup, në mënyrë që t'i analizojë politikën dhe praktikën gjatë rikonstruksionit të të njëjtave, si dhe t'i vlerësojë nga aspekti i të drejtave themelore të qytetarëve dhe veçanërisht pjesëmarrësit më të rrezikuar në komunikacion. U nxorën konkluzionet, si vijojnë:

- gjatë rikonstruksionit të rrugëve në Shkup pak ose aspak nuk mbahet llogari për pjesëmarrësit në komunikacion, të cilët nuk drejtojnë mjete motorike, ndërsa siguria e tyre në përgjithësi është e rrezikuar edhe në rrugët e sapo të rikonstruktuar;
- siguria e të gjithë pjesëmarrësve në komunikacion dhe sidomos e kategorive vulnerabile, është veçanërisht e rrezikuar;
- gjatë planifikimit dhe rikonstruksionit të rrugëve në Shkup, rrallë ose aspak nuk mbahet llogari për të drejtat, dinjitetin dhe integrimin e grupmoshave më të vjetra, personave me aftësi të kufizuara ose personave që kanë nevojë për ndihmë gjatë lëvizjes, mbrojtjen dhe qëndrueshmërinë e mjedisit jetësor;
- gjatë planifikimit dhe rikonstruksionit të rrugëve në Shkup intervenohet në situatën ekzistuese dhe nuk anticipohet ardhmëria dhe zhvillimi i nevojave dhe shprehive të qytetarëve;
- nuk ekziston distinkcion dhe as mënyrë për integrimin e llojeve të ndryshme të komunikacionit që zhvillohet nëpër rrugë (dinamik-statik, këmbësor-çiklist);


- rikonstruksioni i rrugëve në Qytetin e Shkupit më së shpeshti bëhet në llogari të personave që nuk drejtojnë automjete dhe në dobi të qarkullimit me automobil;
- rrugët e sapo rikonstruktura i motivojnë shoferët t'i drejtojnë automjetet e tyre me shpejtësi më të madhe sesa më herët;
- bordurat e reja të rrugëve, rampat për hyrje dalje, mbikalimet dhe vijat e kullimit, pajisja urbane dhe reklamuese nuk janë standarde dhe paraqesin pengesa të palogjikshme për pjesëmarrësit në komunikacion të cilët nuk janë me automjete;
- regjimi i instaluar i ri i parkimeve është orientuar drejt gjenerimit të profitit dhe jo në drejtim të mbrojtjes së personave që nuk janë shoferë dhe në drejtim të vendosjes së rendit në komunikacion;
- probleme me parkimin dhe revolt tek qytetarët shkaktojnë edhe kompetencat e pazgjidhura midis Qytetit të Shkupit dhe komunave përkatëse;
- këmbësorët në të shumtën e rasteve detyrohen të lëvizin nëpër rrugë ose të bëjnë rrethe të paplanifikuara jashtë rutës së planifikuar për shkak të automjeteve të parkuara;
- furnizimi me mall në dyqanet lokale bëhet në çdo kohë të ditës dhe kjo është njëra nga pengesat më të mëdha të zhvillimit papengesë të komunikacionit;
- nuk ekziston kurrfarë angazhimi për mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit jetësor urban, por përkundrazi, në llogari të zgjerimit të rrugëve ose shtigjeve për këmbësorë shkatërrohet edhe gjelbërimi ekzistues i lartë;
- qytetarët, bizneset lokale dhe institucionet lokale nuk konsultohen për nevojat dhe sugjerimet e tyre gjatë planifikimit të rrugëve të reja.

Pjesa më e madhe e problemeve ka zgjidhje të thjeshtë, ndërsa në gjendjen aktuale politike në Maqedoni, kjo shpesh varet nga vullneti i bartësve të funksioneve publike ose nga oferta me orientim më të mirë të tregut në tenderin publik.

Rekomandime konkrete të mbështetura në rezultatet e këtyre hulumtimeve:

- sinkronizimi i kornizës përkatëse ligjore me rregulloret evropiane, veçanërisht Kapitulli 23, Karta e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Bashkimit Evropian;
- implementimi i kornizës së reformuar ligjore;
- punësimi dhe angazhimi i kuadrove me arsim të lartë nga fusha e inxhinierisë së komunikacionit, sociologjisë dhe mjedisit jetësor në institucionet përkatëse publike;
- analizë dhe praktikimi i shembujve dhe praktikave të mira të politikave publike vendore dhe të huaja;
- hulumtim dhe analizë në terren të mënyrës së përdorimit të hapësirës dhe shprehive e nevojave të qytetarëve të komunitetit lokal, para krijimit të politikave të reja publike;

- trajtim të rrugëve të rikonstruara, si pjesë të sistemit të komunikacionit, jo vetëm në kuadër të kufijve të tyre fizik;
- sigurim të transportit publik më cilësor, me qëllim të dekurajimit të shfrytëzimit të automjeteve personale;
- inkorporimi i regjimeve të veçanta të komunikacionit (sipas shembullit, çift-tek, më shumë udhëtarë në automjet, sistemi i zonave, etj.);
- inkorporimi i sistemit të parkimit më restriktiv, me qëllim të dekurajimit të shfrytëzimit të automjeteve personale;
- inkorporimi i regjimit të komunikacionit lokal për furnizimin me mall, dërgimi/marrja (transporti) e fëmijëve në shkollë dhe ngjashëm;
- implementimi dhe respektimi i rreptë i kornizës ligjore, e cila e rregullon gjelbërimin urban dhe mjedisin jetësor urban.



Instituti  
për  
politikë  
evropiane.  
Shkup

Ky projekt është financuar  
nga Bashkimi Evropian dhe Mbretëria e Holandës



Kingdom of the Netherlands